

TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE E RAJONIT TË HASIT

TEMA PËR TITULLIN MASTER I SHKENCËS NË DEPARTAMENTIN E
SOCIOLOGJISË

nga

ALKETA MUSAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË
Prishtinë

tetor, 2021

EKSPOZE E TEMËS

Trashëgimia natyrore dhe kulturore e rajonit të Hasit

Kandidatja: Alketa Musaj

Mentori: Prof. Dr. Shemi Krasniqi

Zona etnografike dhe gjeografike e Hasit është një vend malor, me gjithsej 70 fshatra, ku 42 prej tyre gjenden në territorin e Kosovës dhe 30 në territorin e Shqipërisë. Por, fokusi i këtij studimi mbetet rajoni i Hasit të Kosovës, e veçanërisht trashëgimia natyrore dhe kulturore e këtij rajoni, ku janë interpretuar, analizuar dhe kontekstualizuar këto vlera trashëgimore.

Hulumtimi përmban hyrjen, pesë kapituj, si dhe përfundimin.

Hyrja: e këtij studimi përmbanë një përshkrim të shkurtër dhe të përgjithësuar të historisë dhe gjeografisë të rajonit të Hasit. Gjithashtu dhe përshkrimin e detajuar të definicioneve trashëgimi natyrore dhe kulturore.

Kapitulli i parë: prezanton dhe analizon diversitetin e trashëgimisë natyrore. Ku janë përfshirë: male, pyje, bjeshkë, stane, formacione shkëmbore, shpella, lumenjë, burime uji, por edhe elemente të aspektit botanik. Vlera dhe rëndësia e të cilave në këtë studim nuk kufizohet vetëm në aspektin funksional dhe estetik që kanë këto vlera trashëgimore natyrore si peizazhe të bukura, por edhe në atë të bashkëjetesës apo ndërveprimit të përditshëm me to, si dhe bashkëndjesisë së banorëve lokalë me mjedisin e këtij rajoni.

Kapitulli i dytë: shtjellon trashëgiminë arkeologjike, si vlerë e veçantë për cilindo vend që e posedon, ruan, interpreton dhe bashkëjeton me të. Pasi përmes saj ndër tjerash dëshmohet civilizimi dhe kultura e atij vendi apo rajoni, e që në këtë studim fokusi është në rajonin e Hasit. Ku përfshihen fortifikatat, vendbanimet, tumat, si dhe gjetjet e ndryshme arkeologjike të zbuluara gjatë periudhave të ndryshme në hapsirat e kësaj zone.

Kapitulli i tretë: ka në fokus trashëgiminë arkitekturore të Hasit. Ky segment i trashëgimisë, ngërthen në vete ndërtimet si: shtëpitë, shkollat, objektet e kultit fetarë, urat, rrugët,

muret, mullinjhtë, krojet etj. Interpretohet dhe analizohet rëndësia e tyre ndër vite, gjithashtu bashkjetesa dhe relacioni që banorët e këtij rajoni kanë me këto objekte.

Kapitulli i katërt: përfshinë trashëgiminë etnologjike, e që Hasi njihet si zonë e pasur me këtë element të trashëgimisë të kultivuar ndër vite. Veshja e njohur me emrin “Kullana”, është karakteristike e kësaj zone, e cila përveç ngjyrave dhe elementeve të veçanta që bartë në vete për nga aspekti estetik, gjithashtu është analizuar edhe funksionaliteti që ka pasur dhe ka në periudha të ndryshme kohore. Përveç veshjes, rëndësi i është kushtuar edhe enëve të ndryshme, me të cilat hasjanët kanë bartë ujin nga vendburime të ndryshme, shpeshherë edhe të largëta me kilometra të tëra nga vendbanimet e tyre. Si dhe qëndisjet punëdore, zbukurimet e drurit, e veglat me funksione të ndryshme që kanë përdorur, ose që vazhdojnë t’i përdorin edhe në ditët e sotme, varësisht nga ajo se sa arrijnë të ruhen dhe kultivohen këto elemente të trashëgimisë.

Kapitulli i pestë: interpreton dhe analizon trashëgiminë shpirtërore ose jo materiale. Ku edhe ndahen në nënkapituj të veçantë elemente të ndryshme të këtij dimensionit të trashëgimisë, duke filluar nga mitet dhe legjendat, ritualet dhe simbolet, folklori dhe festat, si dhe vlerat morale. Poashtu, kur flasim për trashëgiminë shpirtërore të këtij rajoni, nuk ka sesi të lihen anash tradita letrare dhe artistike e Hasit. Duke pas parasysh festivalet dhe manifestimet me karakter letrar, kulturor e shkencor, si dhe kontributin në të mirën e përgjithshëm të figurave të shquara me origjinë nga Hasi, në fusha të ndryshme, kontribut i cili nuk kufizohet vetëm në hapsirën lokale, por edhe atë rajonale e më gjerë.

Metodologjia:

Tema e cila për fokus ka vlera të trashëgimisë kulturore dhe asaj natyrore, ka kërkuar edhe çasje të ndryshme metodologjike, për të arritur realizimin e saj. Duke filluar përmes etnografisë si një ndër metodat kryesore të këtij hulumtimi, në kuadër të së cilës janë realizuar vizitat në terren, me një çasje holistike për të parë se si jetojnë banorët e këtij rajoni, resurset e vendit, ndërtimi i shtëpive, rrugëve dhe mureve. Metodë kjo e pasuruar edhe me teknikën e të vërejturit me pjesëmarrje dhe videografisë.

Gjithashtu janë realizuar edhe intervistat e thella, si dhe interpretimi, analizimi dhe kontekstualizimi i narrativave dhe historive gojore. Duke mos lënë anash shtjellimin e literaturës

bazë, por edhe burime tjera sekondare, ku janë përfshirë dokumentarë, publikime dhe raporte të ndryshme.